



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 17, paragrafi 1, pika e të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e jashtëzakonshme, të mbajtur më 08.03.2018, miratoi këto

**R e k o m a n d i m e:**

1. Të fuqizohet mekanizmi për koordinim në Komunën e Prishtinës mbi dhunën në familje, me qëllim që të përmirësohet koordinimi midis institucioneve përkatëse dhe të ofrohet një qasje e përmirësuar e raportimit nga Njësia për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore;
2. Të kërkohen burime shtesë financiare nga buxheti i shtetit dhe donatorët për të financuar strehimoret, strehimin social dhe aktivitetet që lidhen me mbrojtjen nga dhuna në familje;
3. Policia e Kosovës të sigurojë linjë të veçantë telefonike për raportimin e dhunës në familje;
4. Të bëhet përforcimi i zyrës sociale në komunën tonë, shtimi i punëtorëve dhe zgjatja e orarit të punës në këtë zyrë;
5. Të bëhet sensibilizimi i luftës kundër dhunës në entet shkollore, si dhe organizimi i punëtorive të ndryshme për këtë lëmë;
6. Të bëhet emërtimi i disa rrugëve me emrat e grave të cilat kanë dhënë kontribut në komunën tonë lidhur me barazinë gjinore.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-011/02-57594/18, më 09.03.2018



**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Agim Kuleta**